



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI I MINISTRAVE
MINISTRI PËR ÇËSHTJET VENDORE



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E INTEGRIMIT
EVROPIAN



SHOQATA
PER AUTONOMINE
VENDORE



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Tiranë, 5 Dhjetor 2016

Marrëveshje Mirëkuptimi për projektin "Bashkitë për në Europë"

Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, Ministri për Integrimin Evropian, gjashtëdhjetë e një bashkitë e Shqipërisë, të përfaqësuara nga shoqatat e tyre, janë mbledhur së bashku për të bashkëpunuar në mënyrë që të forcojnë kapacitetet e bashkive për çështjet e BE-së dhe për të përhapur tek qytetarët shqiptarë dhe administrata vendore informacionin dhe njohuritë në lidhje me BE-në, politikat dhe programet e saj.

Partnerët e sipërpërmendur, kanë rënë dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje Mirëkuptimi që përcakton angazhimet e marra nga secila palë në kuadrin e projektit të financuar nga BE-ja "Bashkitë për në Europë".

Fokusi i këtij projekti, që pritet të fillojë në pranverën e vitit 2017 dhe do të zgjasë për një periudhë 18 mujore, do të jetë sjellja e njohurive rreth BE-në dhe në veçanti rritja e kapaciteteve të autoriteteve vendore në Shqipëri për të absorbuar fonde nëpërmjet pjesëmarrës në programet e BE-së, si dhe do të kryhen aktivitete që synojnë lehtësimin e shkëmbimit të eksperiencave midis bashkive si dhe dialogun me Qeverinë dhe BE-në. Koordinatorët e BE-së nëpër bashki do të asistohen gjithashtu për të luajtur një rol si pikë informimi për çështjet e BE-së, nëpërmjet pajisjes me materiale informuese. Gjithashtu, projekti i financuar nga BE-ja, do të ndihmojë bashkitë për të organizuar aktivitete për çështje që lidhen me BE në dhe të cilat mund të prezantohen për, të diskutohen me, dhe të kuptohen nga publiku.

Angazhimet e autoriteteve shqiptare përmbledhen si më poshtë:

- **Bashkitë e Shqipërisë** do të caktojnë personel të përshtatshëm si koordinatorë të BE-së, që janë të disponueshëm me informacione për çështjet e BE-së, për pjesën tjetër të administratës si dhe për publikun. Për këtë qëllim, bashkitë do të ofrojnë një zyrë dhe pajisjet e nevojshme (tavinë pune, kompjuter, printer, etj.) Këto ambiente (zyrat e BE-së) duhet të jenë të aksesueshme nga të gjithë qytetarët dhe të pozicionuara mirë, mundësisht në godinën e bashkisë. Koordinatorët e BE-së do të përzgjidhen mbi bazën e aftësive të kërkuara për këtë pozicion (gjuha angleze, njohuri mbi procesin e integrimit, procedurat etj.)
- **Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore** do të sigurojë një ambient zyrtar, përfshirë edhe kostot për shërbimet utilitare, për stafin e projektit të financuar nga BE-ja "Bashkitë për në Europë". Ministri do të sigurojë staf të dedikuar që të punojë me këtë projekt dhe të lehtësojë në veçanti ndërveprimin midis qeverisjes vendore dhe nivelit qendror. Gjithashtu, projekti i BE-së në bashkëpunim me Ministrinë, do të sigurojë një platformë intranet për rrjetëzimin elektronik midis bashkive dhe dialogun me Qeverinë dhe BE-në.
- **Ministri për Integrimin Evropian** do të garantojë staf të dedikuar që të ndihmojë në zbatimin e këtij projekti dhe të lehtësojë në veçanti ndërveprimin midis qeverisjes vendore dhe nivelit qendror. MIE do asistojë Bashkitë në procesin e ngritjes së Zyrave të Integrimit pranë bashkive dhe do mbajë kontakte të ngushta me Koordinatorët përkatës.

Ne të nënshkruarit biem dakord me këtë Marrëveshje Mirëkuptimi. Nënshkruar nga:

Z. Bledar ÇUÇI

Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore,

Znj. Klajda Gjoshja

Ministria për Integrimin Evropian,

Z. Erion Veliaj

Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore,

Znj. Voltana Ademi

Kryetari i Shoqatës së Bashkive,